

Informacion rreth mbledhjes dhe përpunimit e të dhënave tuaja personale në lidhje me aplikimet e bursave

Vigjilenca dhe transparencja formojnë bazën e një bashkëpunimi të bazuar në besim. Kjo është arsyeja pse ne po detajojmë më poshtë se si përpunojmë të dhënat tuaja personale në lidhje me aplikacionin tuaj të bursave dhe si mund të pohoni të drejtat për të cilat keni të drejtë sipas Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) dhe ligjeve të reja lokale për mbrojtjen e të dhënave.

1 Kush është subjekti përgjegjës për përpunimin e të dhënave tuaja (dmth. kontrolluesi i të dhënave)?

Kontrolluesi i të dhënave është:

Yamaha Music Europe GmbH
Siemensstrasse 22-34
D-25462 Rellingen

2 Si mund të kontaktoni me Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave?

Mund të kontaktoni me Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave në:

Yamaha Music Europe GmbH
Për vëmendjen e Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave
Siemensstrasse 22-34
D-25462 Rellingen

Ose: dataprotection@contact.europe.yamaha.com

3 Për cilat qëllime dhe për cilat baza ligjore ne i përpunojmë të dhënat tuaja?

Ne përpunojmë të dhënat personale për ju, për qëllimin e aplikimit tuaj për një bursë, në masën që kjo është e nevojshme për të marrë një vendim për krijimin e një burse për ju me ne. Për më tepër, ne mund të përpunojmë të dhënat personale për ju, ku ne duhet ta bëjmë këtë në mënyrë që të mbrojmë veten kundër kërkesave ligjore të parashtruara kundër nesh në lidhje me procesin e aplikimit. Ne kemi të drejtë ta bëjmë këtë në bazë të Art. 6 para. 1 (f) GDPR, interesi ynë legjitim është, për shembull, një detyrë për të siguruar dëshmi në procedurat sipas ligjeve lokale kundër diskriminimit.

Nëse pranojmë të ju japim një bursë, ne mund të vazhdojmë të përpunojmë çdo të dhënë personale që kemi marrë për ju me qëllime të bursës, nëse kjo kërkohet për të zbatuar ose për të përfunduar bursën.

4 Kujt i shpalosen të dhënat tuaja?

Ne mund t'i zbulojmë të dhënat tuaja personale tek bashkëpunëtorët tanë, nëse kjo lejohet nën qëllimet dhe bazat ligjore të përcaktuara në pikën 3 më lart. Për më tepër, të dhënat personale janë përpunuar në emër tonë në bazë të marrëveshjeve sipas Nenit 28 GDPR.

5 A transferohen të dhënat tuaja në vende jashtë Bashkimit Evropian (të ashtuquajtura vende të treta)?

Vendet jashtë Bashkimit Evropian (dhe jashtë Zonës Ekonomike Evropiane "EEA") merren me mbrojtjen e të dhënave personale ndryshe nga vendet brenda Bashkimit Evropian. Në përpunimin e të dhënave tuaja, ne gjithashtu përdorim ofruesit e

shërbimeve të vëndosura në vënde jashtë Bashkimit Evropian dhe/ose transferojmë të dhëna për kompanitë e grupuara jashtë BE-së.

Për këtë arsye ne kemi zbatuar masa të posaçme për të siguruar që të dhënat tuaja të përpunohen si të sigurtë në ato vende të treta, ashtu siç janë në Bashkimin Evropian. Në kontratat tona me ofruesit e shërbimeve dhe kompanitë e grupeve në vendet e treta, ne përdorim klauzolat standarde të mbrojtjes së të dhënave të ofruara nga Komisioni i Bashkimit Evropian. Këto dispozita parashikojnë garanci adekuate për mbrojtjen e të dhënave tuaja nga ofruesit e shërbimeve në vëndet e treta.

Megjithatë, për të mbrojtur të dhënat tuaja personale ne mbetemi, në çdo rast, linja juaj e parë e kontaktit për ushtrimin e të drejtave tuaja ndaj çdo përfituesi në vëndet e treta dhe transferimi i të dhënave tuaja personale brënda grupit tonë të korporatës vetëm me miratimin tuaj.

6 Sa kohë do të ruhen të dhënat tuaja?

Ne ruajmë të dhënat tuaja personale për aq kohë sa na nevojitet për të marrë një vendim në lidhje me kërkesën tuaj. Nëse nuk ju japim një bursë, mund të vazhdojmë të ruajmë të dhënat kur kjo kërkohet për të mbrojtur veten nga pretendimet e mundshme ligjore. Në çdo rast, dokumentet e aplikimit do të fshihen gjashtë muaj pas shpalljes së vendimit të refuzimit, përveç nëse ne duhet t'i ruajmë ato më gjatë për shkak të mosmarrëveshjes ligjore. Ku i ruajmë të dhënat tuaja personale në bazë të pëlqimit tënd, ne do të vazhdojmë ta bëjmë deri sa të heqësh miratimin tuaj.

7 Cilat të drejta keni në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja?

Ju keni të drejtën e informimit, korrigjimit, fshirjes dhe kufizimit të përpunimit. E drejta për informim dhe e drejta e fshirjes i nënshtrohen kufizimeve të zbatueshme sipas ligjeve lokale të mbrojtjes së të dhënave. Për më tepër, ju keni të drejtë të parashtroni një ankesë pranë autoritetit kompetent mbikëqyrës të mbrojtjes së të dhënave.

Kur përpunimi bazohet në një interes të ligjshëm, ju keni të drejtë të kundërshtoni përpunimin për arsye që lidhen me situatën tuaj të veçantë. Në rast se kundërshtoni, ne nuk do të përpunojmë më të dhënat tuaja personale nëse ne nuk demonstrojmë baza bindëse ligjore për përpunimin e të cilave mbizotërojnë interesat, të drejtat dhe liritë tuaja, ose për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e kërkesave ligjore.

Kur përpunimi bazohet në pëlqimin tuaj, ju keni të drejtë të tërhiqni pëlqimin tuaj me efekt për të ardhmen.

Për të ushtruar të drejtat tuaja, ju lutemi na kontaktoni ose Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave.

8 A jeni të detyruar të jepni të dhënat tuaja personale?

Nuk ka dispozita ligjore ose kontraktuale që kërkojnë dhënien e të dhënave personale, as nuk jeni i detyruar të jepni të dhënat tuaja personale. Megjithatë, sigurimi i të dhënave personale kërkohet për të marrë një bursë prej nesh. Kjo do të thotë që nëse nuk jepni të dhëna personale së bashku me kërkesën tuaj, ne nuk do të jemi në gjendje t'ju ofrojmë një bursë.



9 Ndryshime në këtë informacion

Nëse qëllimi për të cilin përpunohen të dhënat tuaja personale ose mënyra në të cilën ndodh përpunimi ndryshon në mënyrë të konsiderueshme, ne do ta përditësojmë këtë informacion paraprakisht dhe do t'ju informojmë për ndryshimet në kohën e duhur.

Modifikuar: Shtator 2018